



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 520 Prot.

Patos, më 17/02 /2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT – VENDIM

Nr. 08 datë 17 / 02 /2025

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR
QYTETARIN BARDHUL ALIAJ**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” pika 2, gërma “a” dhe V.K.M-së nr. 459 datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionin e qirasë ose uzufuktit, mënyra e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjese për strehim, si dhe V.K.B-së nr. 87 datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë bonusin e qirasë për periudhën 1-vjeçare Janar - Dhjetor 2025 për qytetarin z. Bardhul Aliaj në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
2. Ky rimbursim të bëhet me 2 (dy) këste pasi qytetarit mund t'i ndryshojë statusi social, dhe me vërtetimin pas 6-muajsh të rimbursohet pjesa e mbetur.

Ekipi i Programit të Strehimit Social

Ermenita Mici
Drejtuese Programit

Fabjola Hoxha
Anëtar

Nurkë Hazizaj
Juriste

Arben Shpërdheja
Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 520/Prot.
11

Patos, më 17/02/2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR
QYTETARIN BARDHUL ALIAJ**

Në vijimësi të kërkesës të z. Bardhul Aliaj për të përfituar bonusin e qirasë si familje në nevojë theksojmë se:

Z. Bardhul Aliaj banues në lagjen “Naftëtari” Patos, ka plotësuar dokumentat për tu trajtuar me një nga format e strehimit sipas ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin Social”, dhe figuron në listën e strehimit. Familja e tij përbëhet nga tre persona dhe në përbërjen familjare ka bashkëshorten me aftësi të kufizuar, e verbër grupi dytë. Bazuar normave të strehimit kjo familje duhet të strehoet në banesë 1+1. Të ardhurat e familjes janë në total 71,491 (shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë. Sipas kontratës së qirasë me nr. repertori 615, nr. koleksioni 201, datë 01.03.2022, familja e z. Bardhul Aliaj jeton në këtë banesë, me numër pasurie 7/81+2-22, zona kadastrale 2890, volumi 8, faqe 120, me sipërfaqe 55 m² (pesëdhjetë e pesë) në lagjen “Naftëtari” kundrejt vlerës 5,000 (pesë mijë) lekë në muaj, me një afatë kohor kontrate 5 (pesë) vjecare. Në V.K.B nr. 87 datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit 2025, është miratuar zëri rimbursimi i familjeve të pastreha për bonus qiraje. Për familjet që si pjesë taksuese sipas normave të strehimit duhet të strehohen në banesën 1+1, vlera në tregun e lirë e tetstuar është 5,000 (pesë mijë) lekë dhe rimbursim 50% e vlerës është e barazvlefshëme me 2,500 (dy mijë e pesqind) lekë në muaj. Për periudhën një vjeçare Janar-Dhjetor 2025 një vlerë totale 30,000 (tridhjetë mijë) lekë. Kjo vlerë të rimbursohet me dy këste, pasi qytetarit mund ti ndryshoj statusi social. Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” pika 2, gërma “a” dhe V.K.M-së nr. 459 datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionin e qirasë ose uzufruktit, mënyra e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim, si dhe V.K.B-së nr. 87 datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë, miratimin e këtij projektvendimi.

Ekipi i Menaxhimit të Programit të Strehimit Social

Ermenita Mici

Fabjola Hoxha

Arben Shpërdheja

KRYETARI
Eaton Duro